Po ju dërgoj këtë letër për t'ju informuar se Instituti Kombëtar i Statistikës (ISTAT), organizëm që prodhon statistika publike italiane e bashkëbisedues i Bashkimit Europian, do të zhvillojë në muajin tetor 2011 **Regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë e të banesave n. 15**, anketë e parashikuar nga Programi Statistikor Kombëtar 2011-2013 (kodi IST-02406).

Regjistrimi bëhet çdo dhjetë vjet në të gjithë territorin kombëtar e përfaqëson një anketë të rëndësishme që do të mundësojë njohjen e strukturës demografike e shoqërore të Italisë e të territorit të saj, marrjen e informacioneve të dobishme për kuptimin më të mirë të realitetit ku jetojmë dhe për marrjen e vendimeve më të vetëdijshme nga ana e Institucioneve, e ndërmarrjeve dhe e qytetarëve. Në fakt, do të jemi pikërisht ne qytetarët protagonistët e vërtetë të anketës e do të jetë i vyeshtë bashkëpunimi i të gjithëve. Midis të tjerash, disa të dhëna do të përdoren nga Komunitatet për rishikimin e gjendjeve civile. Prandaj ju ftoj të ndihmoni për përfundimin e mbarë të kësaj ankete të rëndësishme e delikate duke iu përgjigjur, mundësisht nëpërmjet internetit, pyetjeve të pyetësorit, që do të gjeni bashkëlidhur me këtë letër së bashku me *udhëzimin për përpilimin*. Meqë data e referimit të Regjistrimit është **9 tetori 2011**, ju lutem të mos e përpiloni pyetësorin para kësaj date.

Dëshiroj t'ju siguroj për mbrojtjen e të dhënave dhe të informacioneve që do të na jepni duke iu përgjigjur pyetjeve të ndryshme. Të dhënat e mbledhura me rastin e Regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, në fakt mbrohen nga dispozitat në lëmin e sekretit statistikor dhe i nënshtrohen ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (Dekreti legjislativ n. 196/2003). Saktësisht mund të jenë të përdorura, edhe për trajtime të mëpasshme, vetëm për qëllime statistikore nga subjektet e Sistemit statistikor kombëtar e nga organizmat e regjistrimit dhe mund të jenë të komunikueshme për qëllime kërkimore shkencore sipas kushteve e sipas mënyrave të parashikuara nga neni 7 i Kodit të deontologjisë për trajtimet e të dhënave personale për qëllime statistikore.

Istat është i detyruar me ligj ta zhvillojë Regjistrimin e popullsisë e të banesave dhe qytetarët janë të detyruar me ligj të marrin pjesë. Detyrimi për dhënien e përgjigjeve dhe zbatimin e sanksioneve në rast shkelje të tij disiplinohen nga nenet 7 e 11 të d.lgs. n. 322/1989, e ndryshime e plotësime të mëtejshme. Megjithatë, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, ju mund të vendosni t'i përgjigjeni ose jo disa pyetjeve për të ashtuquajturat "të dhëna të ndjeshme" që janë në seksionin e pyetësorit "*Vështirësi në veprimtaritë e jetës së përditshme*". Duke pasur parasysh rëndësinë e regjistrimit, do t'ju jem mirënjohës në rast se do t'i jepni gjithsesi këto të dhëna. Për këtë çështje ju informoj se të dhënat e regjistrimit mund të jenë të shpërndara, pa pjesët identifikuese të drejtpërdrejta, edhe me shpeshësi më pak se tre njësi, çka nuk mund të bëhet me të dhënat me karakter të ndjeshëm.

Titullari i trajtimit të të dhënave personale është Istat - Instituti Kombëtar i Statistikës, Via Cesare Balbo 16 - 00184 Roma; përgjegjës i trajtimit për Istat-it është Drejtori Qendror i Regjistrimeve të Përgjithshme, të cilin mund t'i drejtoheni edhe për të njohur emrat e përgjegjësve të tjerë e për sa i përket ushtrimit të të drejtave të interesuarit.

Për informacione të mëtejshme mund të telefononi në numrin jeshil 800 069 701 që funksionon çdo ditë, nga 01 tetori 2011 deri më 29 shkurt 2012 (përveç datës 25 dhjetor 2011 e 01 janar 2012) nga ora 9.00 deri në orën 19.00 e në periudhën 09 tetor - 19 nëntor 2011 nga ora 8.00 deri në orën 22.00 ose mund të shkruani në adresën e postës elektronike infocens2011@istat.it.

Duke ju falënderuar që në këtë çast juve e familjen tuaj për bashkëpunimin e vyer, ju dërgoj përsëritet me të përzemërta.

Enrico Giovannini

SEKRETI STATISTIKOR, DETYRIMI I PËRGJIGJES, MBROJTJA E KARAKTERIT REZERVAT E TË DREJTAVE TË INTERESUARVE

- Rregullorja (CE) 09 korrik 2008, n. 763 - "Rregullorja e Parlamentit Europian e i Këshillit për regjistrimet e popullsisë e të banesave";
- Dekret Ligji 31 maj 2010, n. 78 i ndërruar me ndryshime në Ligjin 20 korrik 2010, n. 122 - "Masa urgjente në fushën e stabilizimit financiar e të aftësisë konkurruese ekonomike" - neni 50 (Regjistrimi);
- "Plani i Përgjithshëm i Regjistrimit të përgjithshëm të Popullsisë e të Banesave n. 15", adoptuar me vendim të Presidentit të Institutit Kombëtar të Statistikës më 18 shkurt 2011 n. 6/11/PRES (Gazeta Zyrtare datë 08 mars 2011 - seria e përgjithshme - n. 55);
- Dekreti legjislativ 06 shtator 1989, n. 322, e ndryshime e plotësime të mëtejshme, "Rregulla për Sistemin statistikor kombëtar e për riorganizimin e Institutit kombëtar të statistikës" - nenet 6-bis (trajtimit e të dhënave personale), 7 (detyrimi për dhënien e të dhënave statistikore), 8 (sekreti profesional i nëpunësve të zyrave të statistikës), 9 (dispozita për mbrojtjen e sekretit statistikor), 11 (sanksionet administrative), 13 (Programi statistikor kombëtar);
- Dekreti i Presidentit të Republikës më 07 shtator 2010, n. 166, "Rregullorja për riorganizimin e Institutit kombëtar të statistikës";
- Dekreti i Presidentit të Republikës më 30 maj 1989, n. 223, "Miratimi i rregullores së re të gjendjes civile të popullsisë";
- Dekreti legjislativ 30 qershor 2003, n. 196, 196 "Kodi në lëmin e mbrojtjes së të dhënave personale" - nenet 2 (qëllimet), 4 (përkufizimet), 7-10 (të drejtat e të interesuarit), 13 (informativa), 28-30 (subjektet që bëjnë trajtimin), 104-110 (trajtimit për qëllime statistikore ose shkencore);
- "Kodi i deontologjisë dhe i sjelljes së mirë për trajtimet e të dhënave personale për qëllime statistikore e kërkimore të bëra në kuadrin e Sistemit statistikor kombëtar" në veçanti neni 7 (komunikim subjekteve që nuk bëjnë pjesë në Sistemin statistikor kombëtar) e neni 8 (komunikimi i të dhënave midis subjekteve të Sistemit) (Dok. bashkëlidhur A.3 i Kodit në lëmin e mbrojtjes së të dhënave personale - dekreti legjislativ 30 qershor 2003, n. 196);
- Dekreti i Kryetarit të Këshillit të Ministrave 31 mars 2011 - "Miratimi i Programit statistikor kombëtar trevjeçar 2011-2013" (regjistruar në Gjykatën e llogarive më 28 qershor 2011), e masat përkatëse nga të cilat neni 7 i d.lgs. n. 322 i vitit 1989, që përmbajnë përkatësisht listën e anketave për të cilat parashikohet detyrimi i përgjigjes për subjektet private e lista e anketave për të cilat parashikohet zbatimin e sanksioneve në rast shkelje të tij.

Udhëzues për përpilimin e Fletës së Familjes

Formulari CP.1

SEKSIONI I – TË DHËNA PËR FAMILJEN E BANESËN

1 Lloji i banesës e familjes

Pyetja 1.1

Me **Banesë** nënkuptohet një lokal (ose një tërësi lokalesh):

- i destinuar në mënyrë të qëndrueshme për të banuar;
- i ndarë (d.m.th. i rrethuar me mure dhe i mbuluar nga çatia);
- i pavarur (d.m.th. i pajisur me të paktën një hyrje të jashtë ose nga hapësira kalimi të përbashkët – rrugë, oborr, shkallë, kryeshkallë, lozhë, tarraca, etj. - ose një hyrje që të mos lejojë kalimin nëpër banesa të tjera);
- i futur në një ndërtesë (ose që të përbëjë ai vetë një ndërtesë).

Me **Tjetër lloj banese** nënkuptohet një banesë që nuk hyn në përkufizimin e banesës (sepse është e lëvizshme, gjysmë-e përhershme ose e improvizuar), i zënë nga një ose disa persona si vendbanim i zakonshëm ose i përkohshëm në datën e Regjistrimit (si, p.sh. rulot-karavan, tenda, kamper, barakë, kasolle, shpellë, garazh, bodrum, stallë, etj.).

Me **Banesë pranë selisë diplomatike ose konsullore** nënkuptohet një banesë e vendosur në territor të huaj.

Me **Strukturë rezidenciale kolektive** nënkuptohet një strukturë e përdorur si vendbanim për grupe të mëdha personash e/o për një ose disa familje. Në këtë kategori hyjnë hotelet, spitalet, shtëpitë e pushimit për të moshuarit, qendrat e pritjes e institutet me karakter të ndryshëm (fetar, përkujdesës, asistencial, arsimor, etj.).

- Nëse familja banon brenda një selie diplomatike ose konsullore shënoni katrorin 3.
- Nëse familja e ka vendbanimin e zakonshëm në një strukturë rezidenciale kolektive shënoni katrorin 4. Për shembull: një familje që banon zakonisht në një rezidencë ose në dhoma hoteli, ose familjet që e kanë faktuar vendbanimin e vet në banesa që nuk i kanë karakteristikat e banimit dhe që janë të vendosura brenda strukturave rezidenciale kolektive (si, për shembull, familja e rojës së spitalit që jeton në një banesë brenda strukturës).

Familjet tek **Tjetër lloj banese** e tek **Banesë pranë selisë diplomatike ose konsullore**, në Seksionin I, duhet t'u përgjigjen vetëm pyetjeve të pikave 1 (lloji i banesës dhe familja) e 5 (autovetura e vendi i autoveturës) e pyetjeve 6.2 e 6.3.

Familjet tek **Struktura rezidenciale kolektive**, në Seksionin I, duhet t'u përgjigjen vetëm pyetjeve 1.1 e 1.4.

Pyetja 1.2

Shënoni katrorin 1 nëse banesa është e zënë vetëm nga një familje; shënoni katrorin 2 nëse në banesë bashkëbanojnë dy ose më shumë familje. Saktësohet se vetëm në mungesë lidhjesh personale ose ndjenjash bashkëprania në të njëjtën banesë mund të çojë në përcaktimin e disa familjeve bashkëbanuese.

Pyetja 1.3

Përgjigjen vetëm familjet që në pyetjen 1.2 kanë shënuar katrorin 2. Vetëm në këtë rast duhet shënuar, në kuadrin e posaçëm, kodin e pyetësorit të çdo familjeje bashkëbanuese (përfashtuar e vetja) dhe mbiemri e emri i titullarit të familjes/familjeve bashkëbanuese. **Kodi i pyetësorit** është një numër identifikues univok me 13 shifra që gjendet lart djathtas në faqen e parë të çdo Flete të Familjes.

Nëse në banesë bashkëjetojnë më shumë se 4 familje është e nevojshme të telefonohet në numrin jeshil 800-069701.

Pyetja 1.4

Shënoni katrorin 1 në rastin kur banesa është pronë ekskluzive ose e përbashkët e të paktën njërit prej personave që banojnë aty. Shënoni katrorin 1 edhe kur në banesë jetohet me të drejtë përdorimi, ose duke gëzuar ndonjë të drejtë tjetër reale (për shembull përdorimi, banimi) ose kur banesa është objekt riblerjeje, ose sepse është shitur vetëm pronësia, e gjithashtu nëse pronari jep me qira pjesë të shtëpisë së tij duke vazhduar të jetojë po aty.

Shënoni katrorët 2 o 3 kur banesa nuk është pronësi e askujt nga personat që banojnë aty, por e marrë me qira (katrori 2), ose e zënë sipas ndonjë të drejte tjetër (katrori 3), d.m.th. falas ose si shërbim.

2 Pronësia e struktura e banesës

Pyetja 2.1

Tregoni pronarin e banesës midis atyre në listë duke shënuar një katror të vetëm. Nëse pronësia është e ndarë midis disa subjekteve (privatë, ndërmarrje, etj.) shënoni pronarin që mban kuotën më të madhe të pronësisë. Në rast pronësie të vetme referojuni pronarit të pronësisë.

Pyetja 2.2

Tregoni me metra katrorë (të rrumbullakosur pa numra dhjetorë) sipërfaqen e brendshme të banesës, domethënë sipërfaqen e dyshemesë pa muret (sipërfaqja e banimit) e duke përjashtuar vetëm ballkonet, tarracat e hapësirat përkatëse (për shembull bodrumet, nënçatitë, garazhet, etj.). Nëse banesa shtrihet në disa nivele, ose përfshin edhe dhoma me hyrje të pavarur, duhet mbledhur sipërfaqja e të gjitha pjesëve.

Pyetja 2.3

Tregoni numrin e përgjithshëm të dhomave të banesës duke përjashtuar banjat, kuzhinat, anekset e kuzhinës, hapësirat ndihmëse(depo) dhe hapësirat përkatëse (p.sh. bodrumet, nënçatitë, garazhet, etj.). Duke bërë këtë llogaritje duhet pasur parasysh se:

- duhen të konsiderohen si pjesë përbërëse të banesës edhe dhomat me hyrje të pavarur, por të lidhura nga pikëpamja funksionale me të dhe të përdorura nga familja;
- një lokal i madh i nrytuar me shumë pjesë me funksione të ndryshme, ose i ndarë në dy ose më shumë lokale nga harqe ose nga ndarës të lëvizshëm, duhet të llogaritet jo si një dhomë e vetme, por si disa dhoma;
- duhen llogaritur edhe dhomat me aneks kuzhine të destinuar për shumë veprimtari.

Për t'iu përgjigjur siç duhet pyetjes, përmbajuni përkufizimeve të mëposhtme:

Dhomë: nënkuptohet një lokal që merr ajër e dritë të drejtpërdrejtë nga jashtë dhe ka përmasa të tilla sa të lejojë vendosjen e një shtrati duke lënë hapësirë të dobishme për lëvizjen e një personi. Janë dhoma, për shembull, dhomat dhe dhoma e ndenjjes, në qoftë se respektojnë karakteristikat e dhëna. Kuzhinat, anekset e kuzhinës, hapësirat ndihmëse (depo) dhe banjat nuk duhen llogaritur si dhoma, edhe pse mund të kenë karakteristikat e tyre. Dhomat pa të paktën një dritare nuk duhen llogaritur me kusht që të mos kenë funksione shtëpiake, si për shembull një dhomë gjumi.

Dhoma me hyrje të pavarur: nënkuptohet ato që kanë një hyrje jashtë në krahasim me të tjerat që përbëjnë trupin kryesor të banesës dhe që janë fizikisht të ndara nga ai. Megjithatë këto dhoma janë funksionalisht plotësuese për banesën dhe përdoren nga po ata persona që e banojnë.

Hapësirat përkatëse: janë bodrumet, nënçatitë, garazhet, etj. d.m.th. lokalet e destinuar dhe efektivisht të përdorura për kohë të gjatë në shërbim të banesës (edhe pse nuk i përkasin të njëjtës ndërtesë).

Hapësirë ndihmëse nënkuptohet lokali i destinuar për kalimin midis dhomave, për shërbimet higjienike dhe shëndetësore, si dhe për depo e të ngjashme. Janë pra hapësira ndihmëse hyrjet, shkallët e brendshme, korridoret, banjat, dhomat e zhveshjes, depot, etj.

Kuzhina: nënkuptohet lokali (ose pjesë e tij) i pajisur me impiant për gatimin e ushqimeve dhe me impiant për pastrimin e enëve të gatimit, i përdorur për këto qëllime pavarësisht nga fakti se përdoret edhe për të ngrënë, për të fjetur e për veprimtari të tjera. Në funksion të përmasës e të përdorimit të lokalit ku gatuhet, përcaktohen tre tipologji:

- kuzhina me karakteristika të dhomës:** është rasti i kuzhinës "tradicionale", e përdorur dhe e pajisur kryesisht për të gatuar e për të ngrënë e me përmasat e një dhome (shiko përkufizimin);
- aneksi i kuzhinës:** është një kuzhinë e vogël, më pak se përmasa minimale të dhomës, gati gjithnjë e mjaftueshme vetëm për vendosjen e impianteve të nevojshme;
- aneksi për gatim në dhomë i destinuar për shumë veprimtari:** është rasti i lokaleve të mëdha, të përdorura për të konsumuar vaktet, e gjithashtu si dhomë e vogël ngrënieje, ose në të cilën një pjesë i kushtohet vendosjes së impianteve të kuzhinës. Një dhomë e tillë nuk është kryesisht kuzhinë, por dhomë që përdoret në mënyra të ndryshme.

Pyetja 2.4

Duhen konsideruar dhoma për përdorim profesional (si studio e një profesionisti të lirë, zyra e një të vetëpunësuar, laborator i një artizani) ato që përdoren vetëm për veprimtarinë e një ose disa personave që jetojnë në banesë.

Pyetja 2.5 (mund të ketë disa përgjigje)

Për përkufizimet e kuzhinës, aneksit të kuzhinës e aneksit të gatimit shiko pyetjen 2.3. Nëse disponohen më shumë se një kuzhinë duhet saktësuar numri. Shënoni vetëm katrorin 4 nëse nuk disponohet kuzhina, aneksi i kuzhinës ose aneksi i gatimit.

3 Uji dhe impiantet higjieniko-shëndetësore

Pyetja 3.1 (në rast pohimi, mund të jepen disa përgjigje)

Shënoni katrorin 3 nëse uji i pijshëm vjen nga një burim i ndryshëm nga ujësjellësi ose pusi: për shembull, një burim jo i drejtpërdrejtë si cisterna që mbushet periodikisht. Shënoni katrorin 4 nëse banesa ka brenda saj vetëm ujë jo të pijshëm.

Pyetja 3.2

Për disponueshmëri të ujit të ngrohtë (për përdorim higjieniko-shëndetësor në banjë e/o në kuzhinë: ujë i ngrohtë shëndetësor) nënkuptohet ai që ngrohet nga një impiant fiks e jo nga furnela ose sisteme të tjera ngrohëse.

Pyetja 3.3

Përgjigjuni “Po” (katrori 1) kur uji i ngrohtë furnizohet ekskluzivisht nga vetë impianti ngrohës i banesës. Përgjigjuni “Jo” (katrori 2) nëse uji i ngrohtë përftohet nga një impiant i veçuar, si skaldabanja me gaz ose elektrike. Përgjigjuni “Jo” (katrori 2) edhe nëse uji i ngrohtë përftohet vetëm pjesërisht nga përdorimi i paneleve diellore.

Pyetja 3.4 (mund të ketë disa përgjigje)

Përgjigjuni vetëm në rast se ka një impiant prodhimi uji të ngrohtë i veçuar nga ai i ngrohjes.

Pyetja 3.5

Me vaskë dushi e banje nënkuptohen ato impiante që janë të lidhura në mënyrë fikse me impiantin e ujit e me atë të shkarkimit të ujërave të zeza, brenda banesës ose në dhomat me hyrje të pavarur.

Përgjigjuni duke pasur parasysh se dushi ose vaska e banjës midis tyre të ndara e të vendosura në të njëjtin lokal duhen konsideruar si dy impiante e se vaska e banjës tek e cila përfshihet edhe impianti i dushit duhet konsideruar si një impiant i vetëm.

Pyetja 3.6

Me banjë nënkuptohet një WC i lidhur në mënyrë fikse me impiantin e ujit e me atë të shkarkimit të ujërave të zeza, në banesë ose në dhomat me hyrje të pavarur.

4 Impianti i klimatizimit (ngrohja, ajri i kondicionuar, energjia e ripërtëritshme)

Pyetja 4.1

Përgjigjuni “Jo” (katrori 2) nëse banesa nuk disponon asnjë impiant ngrohjeje ose po pati vetëm aparate të lëvizshme si soba elektrike, me gaz ose me energji tjetër.

Pyetja 4.2 (mund të ketë disa përgjigje)

Për t’iu përgjigjur siç duhet pyetjes, përmbajuni përkufizimeve të mëposhtme:

Impiant i centralizuar: nënkuptohet ai që shërben për ngrohjen e të gjitha banesave të ndërtesës, por që gjendet jashtë banesës së veçantë, për shembull, në lokalet e shërbimit të ndërtesës (bodrumet, katet përgjysmë nën dhë, etj.). Konsiderohet i centralizuar edhe impianti i lidhur me rrjetin qytetar të telengrohjes.

Impiant fiks autonom: nënkuptohet ai që shërben për ngrohjen e një banese të vetme e normalisht gjendet brenda tij ose afër tij (p.sh. kaldaja mund të gjendet në një hapësirë të brendshme të posaçme, ose në ballkon/tarracë; panelet diellore mund të gjenden në çati, e kështu me radhë) e përdorimi i të cilit administrohet në mënyrë të pavarur.

Aparatet e veçanta fiks: nënkuptohen ato që nuk lidhen me një impiant të centralizuar ose fiks autonom, e që nuk janë të transportueshëm: Për shembull, vatrat, radiatorët individualë fiks me gaz, pompat ngrohëse, piastrat elektrike, sobat me qymyrguri, me dru, me kerozen, me GPL (gaz i lëngëzuar i naftës).

Shënoni, për çdo lloj impianti ngrohjeje, lëndën djegëse ose energjinë që e ushqen. Çdo katrori të shënuar i korrespondon një lloj impianti e një lëndë djegëse ose energjie që e ushqen. Për shembull, nëse shënohet katrori 10 do të tregohet një impiant autonom për përdorim vetëm të banesës i ushqyer me GPL, ose në qoftë se shënohet katrori 1 do të tregohet një impiant i centralizuar i ushqyer me metan se me gaz natyror. Për përgjigjet e shumëfishta nëse, për shembull, banesa disponon qoftë impiant autonom me metan, qoftë vatër me dru duhet të shënohen katrorët 8 e 25.

Pyetja 4.3

Përgjigjuni “Po” (katrori 1) nëse banesa është e pajisur me një impiant i destinuar për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme. Burimet energjetike të ripërtëritshme janë “burimet energjetike jo fosile (nga era, diellore, gjeotermike, nga lëvizja e valëve, nga lëvizja e detit, hidraulike, nga biomasa, nga gazi i shkarkimit, nga gazrat e mbetura nga proceset e pastrimit e nga biogazi)” - neni 2 i Dekreti legjislativ Digs 387/03.

Pyetja 4.4

Përgjigjuni “Po” (katrori 1) kur banesa është e pajisur me impiant ajri të kondicionuar fiks (domethënë, fiks i llojit *split* ose fiks monoblok, me panele rrezatuese në dysheme/mur/nënçati, etj.). Përgjigjuni “Jo” edhe nëse dispononi kondicionerë të lëvizshëm.

5 Autovetura dhe vendi i autoveturës

Pyetja 5.1

Me disponueshmëri nënkuptohet jo vetëm pronësia e autoveturës por edhe çdo mundësi tjetër përdorimi ekskluziv nga ana e një anëtari të familjes (qira me kohë të gjatë, përdorues, përfitues, etj.).

Pyetja 5.2

Garazh: nënkuptohet lokali i mbyllur, i përshtatshëm për vendosjen e një ose më shumë automobilave dhe përdoret për këtë qëllim.

Vend për autoveturën në garazh: nënkuptohet ai për përdorim personal e të rezervuar, i vendosur në një lokal të mbyllur të pajisur për vendosjen e shumë automobilave dhe përdoret për këtë qëllim: për shembull, garazhet e kondominiumeve të vendosur poshtë ndërtesës ose garazhet e vendosur në ndërtime të bëra posaçërisht.

Vendi i autoveturës jashtë: nënkuptohet ai, personal e i rezervuar, i vendosur në një hapësirë jashtë: për shembull, brenda oborreve, nën katin *pilotis* të një ndërtese, në katin e fundit të zbuluar të një ndërtese të ndërtuar si parkim e të ngjashme.

Tregoni nëse familja ka të paktën një vend për autoveturë (nëse ka më shumë se një tregoni numrin e saktë), personal e të garantuar, brenda ndërtesës ku jeton ose afër tij. Me disponueshmëri nënkuptohet se përdorimi i vendit të autoveturës është i garantuar (në çdo moment) sepse është në pronësi, është marrë me qira, është falas, etj..

6 Telefoni e lidhja me internet

Pyetja 6.1

Shënoni katrorin 1 ("Po") nëse ka të paktën një telefon fiks në funksionim (falë kontratës me një kompani telefonike). Shënoni katrorin 2 ("Jo") nëse në banesë nuk ka impiant telefonik ose ka një impiant telefonik, por pa kontratë aktive me një kompani telefonike.

Pyetja 6.2

Shënoni katrorin 2 ("Jo") nëse asnjë anëtar i familjes nuk ka celular.

Pyetja 6.3

Tregoni numrin e anëtarëve të familjes që kanë të paktën një telefon celular.

Pyetja 6.4

Shënoni katrorin 1 ("Po") kur ka çfarëdolloj lidhje interneti.

Pyetja 6.5 (*mund të ketë disa përgjigje*)

Shënoni katrorin 3 nëse disponon lidhje me bandë të gjerë me modalitet WI-FI ose lidhje me bandë të gjerë me teknologji WIMAX.

1 Të dhëna për gjendjen civile

Pyetja që ka të bëjë me “marrëdhëniet farefisnore ose të bashkëjetesës me titullarin e Fletës së Familjes” bëhet, së bashku me ato për gjininë, gjendjen civile e datën e martesës, me qëllim që të merren informacione për familjet dhe bërthamat familjare; në veçanti këto pyetje mundësojnë marrjen e informacioneve për përbërjen e tyre, përmasat e tipologjinë (për shembull për numrin e çifteve me fëmijë, për numrin e fëmijëve që jetojnë vetëm me një prind, për numrin e personave që jetojnë vetëm, etj.).

Pyetja 1.1

Tregoni marrëdhënien farefisnore ose të bashkëjetesës me titullarin e Fletës së Familjes. Me titullarin e Fletës së familjes nënkuptohet personi i cili ka emrin në krye të skedës së familjes në Gjendje civile.

- Nuk i përgjigjet kësaj pyetjeje titullari i Fletës së familjes ose personi i referimit (personi 01 i Listës A); përgjigjja rezulton e përpiluar.
- Duhet ta shënojë katrorin korrespondues me modalitetin 03 personi që bashkëjeton në çift me titullarin të Fletës së familjes, qoftë në rastin e çiftit të formuar nga persona me gjini të ndryshme, qoftë në rastin e çiftit të formuar nga persona me të njëjtën gjini.
- Fëmijët duhen klasifikuar si të tillë nëse njihen nga titullari e/o nga bashkëshorti/bashkëjetuesi.
- Fëmijët vetëm të bashkëshortit/bashkëjetuesit të titullarit duhet të shënojnë katrorin 06 (“Djali/Vajza vetëm të bashkëshortit/bashkëjetuesit”), edhe në qoftë se prindi ka vdekur ose nuk jeton zakonisht në banesë.
- Duhet të shënojë katrorin 08 (“Vjehri/vjehrra e titullarit”) edhe prindi (ose bashkëshorti i prindit) i bashkëjetuesit të titullarit.
- Kushërinjtë (me përjashtim të fëmijëve) vetëm të bashkëshortit/bashkëjetuesit të titullarit duhet të shënojnë katrorin e marrëdhënies përkatëse farefisnore, edhe nëse bashkëshorti/bashkëjetuesi i titullarit nuk jeton zakonisht në banesë.
- Kushërinjtë e titullarit e/o të bashkëshortit/bashkëjetuesit të papërmendur tek përgjigjet (xhaxhai/daja e titullarit ose e bashkëshortit/bashkëjetuesit, kushërirri i titullarit ose i bashkëshortit/bashkëjetuesit, etj.), që jetojnë zakonisht në këtë banesë, duhet të shënojnë katrorin 16 (“Tjetër kushëri i titullarit e/o i bashkëshortit/bashkëjetuesit”).
- Personat që jetojnë zakonisht në këtë banesë e nuk kanë lidhje farefisnore me titullarin ose me bashkëshortin/bashkëjetuesin, duhet të shënojnë katrorin 17 (“Tjetër person bashkëbanues pa lidhje çifti, farefisnie o gjaku”). Në rast se këto persona përbëjnë familje më vete, duhet të përpilojnë një tjetër Fletë të familjes.
- Personeli i shërbimit të familjes (shërbyes, bashkëpunëtorë familjarë) që jeton zakonisht në banesë duhet të shënojë katrorin 17. Në rast se përbën familje më vete, duhet të përpilojnë një tjetër Fletë të Familjes.

Pyetja 1.2

“Gjinia” është ndryshorja thelbësore për leximin e të dhënave statistikore në mënyrë të qartë e të krahasuar për burrat e gratë.

Pyetja 1.3

Pyetja për datëlindjen bëhet për të llogaritur moshën sipas viteve të mbushura, me qëllim që të minimizohen rreziqet e gabimit tek të dhënat e moshës së personave.

Datëlindja duhet shkruar me shifra e jo me shkronja; dita dhe muaji duhet të tregohen me dy shifra, duke vënë përpara, nëse duhet, një zero (për shembull: 05/06/1967).

Pyetja 1.4

Pyetja për vendlindjen (vendi ku është bërë lindja) bëhet sepse, duke u lidhur me informacione të tjera (p.sh. me vendin e rezidencës), mund të tregojë lëvizjet e popullsisë brenda Italisë dhe midis Italisë dhe Vendeve të tjera.

- Personat e lindur në komunën ku kanë aktualisht rezidencën duhet të shënojnë katrorin 1 (“Në këtë komunë”).
- Për ata që janë lindur në një komunë tjetër italiane duhet treguar emri i komunës ku personi është lindur. Shënoni emrin e komunës e jo atë të lokalitetit (fraksionit, qendrës së banuar, etj.). Gjithashtu, duhet të jetë e saktësuar sigla e provincës të cilës i përket komuna në datën e Regjistrimit.
- Për të lindurit jashtë shtetit duhet shënuar emri aktual i shtetit të huaj brenda kufijve të sotëm të të cilit gjendet vendlindja. Shteti i huaj i lindjes duhet treguar me shkronja latine e në italisht.

Pyetja 1.5

Pyetja për regjistrimin në Gjendjen civile të komunës lejon përcaktimin me saktësi më të madhe të vendit ku personi është rezident. Komuna e regjistrimit në gjendjen civile ku i interesuari mund të kërkojë dokumentin e vet të identitetit e certifikatat kryesore të gjendjes civile. Titullari përgjigjet vetëm në rast se në faqen e parë të Fletës së familjes mungon adresa e parashtypur.

- Personat e shënuar në Gjendjen civile të komunës ku regjistrohen, duhet të shënojnë katrorin 1 (“Po, në këtë banesë”) ose katrorin 2 (“Po, por në një banesë tjetër ose bashkëjetesë”).
- Për personat e regjistruar në Gjendjen civile të një komune tjetër italiane duhet treguar emri aktual i komunës ku personi është i regjistruar në Gjendjen civile. Tregoni emrin e komunës e jo atë të lokalitetit (fraksionit, qendrës së banuar, etj.). Gjithashtu, duhet të jetë e saktësuar sigla e provincës të cilës i përket komuna.
- Personat e peregjistruar në Gjendjen civile të ndonjë komune italiane duhet të shënojnë katrorin 4 (“Jo, në asnjë komunë italiane”).

*Saktësojmë se me termin **bashkëjetesë** u referohemi për shembull: instituteve arsimore (si kolegje, seminare, etj.), instituteve asistenciale (si jetimore, shtëpi familje, shtëpi pushimi për të rriturit me aftësi të kufizuar e për të moshuar, etj.), instituteve të kurimit (si spitale, klinika, etj.), burgjeve, bashkëjetesave kishtarë, bashkëjetesave ushtarake (spitale ushtarake, burgje ushtarake, kazerma, etj.), hoteleve, pensioneve, bujtinave e të ngjashme si këto, anijeve tregtare (si anije udhëtarësh, etj.), etj..*

2 Gjendja civile e martesë

Pyetja 2.1

- Personat e martuar që nuk jetojnë më me bashkëshortin e vet për shkak të krizës së çiftit duhet të shënojnë katrorin 3 (“I/E ndarë faktikisht”) e jo katrorin 2 (“I/E martuar”).
- Personat e martuar që jetojnë larg bashkëshortit për arsye rastësore ose nevojtare duhet të shënojnë katrorin 2 (“I/E martuar”) e jo katrorin 3 (“I/E ndarë faktikisht”).
- Personat “e martuar prej kohësh” (ose personat që kanë marrë zgjidhjen e martesës ose ndërprerjen e efekteve civile të martesës sipas ligjit 1 dhjetor 1970, n. 898) duhet të shënojnë katrorin 5 (“I/E divorcuar”).

Pyetja 2.2

- Duhet të përgjigjen të gjithë personat që kanë lidhur të paktën një martesë: përveç të martuarve duhet të përgjigjen edhe personat e ndarë faktikisht ose ligjërisht, të divorcuar ose të ve.
- Data e celebrimit të martesës duhet të tregohet me shifra e jo me shkronja (për shembull: 05/1969); në rast se ka disa martesë, shënoni datën e të fundit.

Pyetja 2.3

Pyetja për gjendjen civile para martesës së fundit mundëson marrjen e informacioneve shtesë për formimin e çifteve dhe për tipologjinë e bërthamave familjare.

Tregoni gjendjen civile para martesës së fundit, edhe nëse kjo ka qenë martesë e vetme e lidhur.

Duhet të përgjigjen të gjithë personat që kanë lidhur të paktën një martesë: përveç të martuarve duhet të përgjigjen edhe personat e ndarë faktikisht ose ligjërisht, të divorcuar ose të ve.

3 Nënshtetësia

Pyetjet për nënshtetësinë bëhen për marrjen e informacionit për numrin e personave rezidentë në Itali që kanë nënshtetësinë italiane ose atë të huaj; duke e lidhur me moshën e popullsisë rezidente, informacioni për nënshtetësinë jep, për shembull, numrin e votuesve potencialë dhe karakteristikat e tyre.

Pyetjet për vendlindjen e prindërve (si të nënës ashtu edhe të babait) bëhen me qëllim që të rindërtohet prejardhja e çdo individi, në veçanti e imigrantëve dhe e pasardhësve të tyre.

Pyetja 3.1

- Personat e huaj duhet të shënojnë katrorin 2 e të specifikojnë emrin e shtetit të huaj e të cilit janë qytetarë me shkronja latine e në italisht.
- Personat që kanë, përveç nënshtetësisë italiane, edhe një tjetër shtetësi, duhet të tregojnë vetëm atë italiane (duke shënuar katrorin 1).
- Qytetarët e huaj me shumë nënshtetësi (me përjashtim të nënshtetësisë italiane) duhet të specifikojnë vetëm një shtet të huaj për nënshtetësinë, sipas rendit të përparësisë së mëposhtme: a) Vendet që i përkasin Bashkimit Europian, b) Vendet e tjera. Në rast shtetësisë të shumëfishta brenda grupit a) ose grupit b), duhet të specifikohet vetëm një shtet i huaj sipas dëshirës.
- Personat që nuk kanë asnjë shtetësi duhet të deklarohen apolidë (duke shënuar katrorin 3). Në kategorinë e apolidëve hyjnë edhe personat situata e të cilëve për shtetësinë nuk është sqaruar pas shpërbërjes, ndarjes ose bashkimit të shteteve.

Pyetja 3.2

- Kush është qytetar italian që nga lindja duhet të shënojë katrorin 1 (“Po”), edhe pse i lindur jashtë shtetit.
- Ai që është bërë qytetar italian pas një instance të posaçme dhe pas aktit të dhënies nga ana e autoritetit kompetent, ose kush ka marrë nënshpëtimin italian nëpërmjet martesës, natyralizimit të zakonshëm ose të jashtëzakonshëm, lindje në Itali e rezidencë legale të pandërprerë deri në moshën 18 vjeç, duhet të shënojë katrorin 2 (“Jo”). Duhet të shënojë katrorin 2 edhe ai që është bërë qytetar italian sepse e ka marrë “automatikisht” shtetësinë, për shembull:
 - a) i mituri që e ka marrë shtetësinë italiane sepse është birësuar nga një qytetar italian ose nga njohja e amësisë ose atësisë (ose deklarata gjyqësore e bijësisë) nga ana e prindit italian;
 - b) biri i mitur bashkëjetues me atë që ka marrë nënshpëtimin italian.

Pyetja 3.3

Kush ka shënuar katrorin 2 të pyetjes 3.2 (pra është qytetar italian, por jo që nga lindja):

- duhet të saktësojë nëse e ka marrë nënshpëtimin italian nëpërmjet martesës ose për arsye të tjera (për shembull nëpërmjet natyralizimit);
- duhet të tregojë edhe shtetin e huaj të nënshpëtimin së mëparshme, me shkronja latine e në italisht.

Pyetjet 3.4 e 3.5

Nëse prindërit kanë lindur jashtë shtetit duhet shënuar emri aktual i shtetit të huaj brenda kufijve të sotëm të të cilit gjendet vendlindja. Shteti i huaj i lindjes duhet treguar me shkronja latine e në italisht.

4 Prania e vendbanimi i mëparshëm

Pyetjet e pikës 4 mundësojnë përcaktimin e migrantëve të brendshëm e ndërkombëtarë. Migrantët e brendshëm përkufizohen si ata që janë rezidentë në një komunë në momentin e marrjes së të dhënave, por që kanë qenë rezidentë më parë në një komunë tjetër. Migrantët ndërkombëtarë përkufizohen si ata që, pavarësisht nga Vendi i lindjes e nga nënshpëtimin, kanë qenë, në një moment të jetës së tyre, rezidentë në një Vend tjetër.

Pyetja 4.1

Shënoni katrorin që korrespondon me vendin ku gjendej në ditën e Regjistrimit.

Shënoni katrorin 1 (“Në këtë banesë”) ose 2 (“Në këtë komunë, por në një banesë tjetër ose bashkëjetesë”) edhe në qoftë se personi nuk ishte në komunë më 9 tetor 2011 por ka rishkuar më 10 tetor 2011 e nuk është regjistruar gjatë.

*Saktësojmë se me termin **bashkëjetesë** u referohemi për shembull: instituteve arsimore (si kolegje, seminare, etj.), instituteve asistenciale (si jetimore, shtëpi familje, shtëpi pushimi për të rriturit me aftësi të kufizuar e për të moshuar, etj.), instituteve të kurimit (si spitale, klinika, etj.), burgjeve, bashkëjetesave kishtarë, bashkëjetesave ushtarake (spitale ushtarake, burgje ushtarake, kazerma, etj.), hoteleve, pensione, bujtinave e të ngjashme si këto, anijeve tregtare (si anije udhëtarësh, etj.), etj..*

Pyetja 4.2

Personi që përgjigjet duhet të tregojë nëse ka qenë ndonjëherë rezident jashtë shtetit, pavarësisht nga vendi i lindjes e nga shtetësia e pavarësisht nga transferimet e tjera të rezidencës që mund të kenë ndodhur brenda Italisë.

Duhet të shënojë katrorin 1 vetëm ai që ka jetuar jashtë shtetit të paktën 12 muaj (për arsye familjare, studimi, pune ose tjetër) e nëse mbërritja (ose kthimi) në Itali ka çuar në regjistrimin (ose ri-regjistrimin) në regjistrin e gjendjes civile të një komune italiane.

Pyetja 4.3

Kush ka qenë rezident jashtë shtetit, duhet të tregojë muajin e vitin që korrespondojnë me transferimin e përhershëm në Itali.

Pyetja 4.4

Kush ka qenë rezident jashtë shtetit, duhet të tregojë shtetin e huaj në të cilin ka pasur rezidencën e fundit në bazë të kufijve ndërkombëtarë të sotëm, me shkronja latine e në italisht.

Pyetja 4.5 (Përgjigjet vetëm ai që është 1 vjeç ose më shumë)

Kush ka shënuar katrorin 3 (një vit më parë e kishte vendbanimin e zakonshëm në një komunë tjetër italiane) duhet të tregojë emrin aktual të komunës ku kishte rezidencën. Tregoni emrin e komunës e jo atë të lokalitetit (fraksionit, qendrës së banuar, etj.).

Pyetja 4.6 (Përgjigjet vetëm ai që është 5 vjeç ose më shumë)

Kush ka shënuar katrorin 3 (pesë vjet më parë e kishte vendbanimin e zakonshëm në një komunë tjetër italiane) duhet të tregojë emrin aktual të komunës ku kishte rezidencën. Shënoni emrin e komunës e jo atë të lokalitetit (fraksionit, qendrës së banuar, etj.).

Kush ka shënuar katrorin 4 (pesë vjet më parë e kishte vendbanimin e zakonshëm jashtë shtetit) duhet të specifikojë emrin e shtetit të huaj me shkronja latine e në italisht.

5 Arsimi dhe formimi

Pyetjet 5.1 e 5.2 (Për atë që është më pak se 6 vjeç)

Nuk i përgjigjet këtyre pyetjeve titullari i Fletës së familjes ose personi i referimit (personi 01 i Listës A).

- Për fëmijët që janë më pak se 6 vjeç e që nuk ndjekin as çerdhen as kopshtin, por që frekuentojnë prej kohësh klasën e parë fillore (shkolla parësore), për shembull fëmijët e lindur midis datës 10 tetor e 31 dhjetorit 2005, përgjigjuni pyetjes 5.1 duke shënuar katrorin 3 (“Klasa e parë fillore”).
- Për fëmijët që janë më pak se 6 vjeç e që nuk ndjekin as çerdhen as kopshtin e as klasën e parë fillore (shkolla parësore), përgjigjuni pyetjes 5.1 duke shënuar katrorin 4 e përfundoni përpilimin e Fletës individuale.

Pyetjet 5.3 e 5.4 (Për atë që është 6 vjeç ose më shumë)

Titujt e studimit të radhitur janë ata që merren në kuadrin e sistemit shkollor italian.

- Nxënësit e klasës së parë të shkollës fillore (shkolla parësore) duhet të shënojnë katrorin 02.
- Personat që kanë dy ose më shumë tituj studimi të së njëjtës gradë duhet të tregojnë atë që e konsiderojnë më të rëndësishëm lidhur me profesionin e ushtruar.
- Personat (në veçanti **qytetarët e huaj**) që e kanë marrë titullin e studimit më të lartë **jashtë shtetit** duhet të shënojnë katrorin e titullit korrespondues në Itali.
- Qytetarët e huaj që nuk kanë marrë asnjë titull studimi duhet të zgjedhin midis modaliteteve 01 (“Asnjë titull studimi e nuk di të lexojë ose të shkruajë”) e 02 (“Asnjë titull studimi, por di të lexojë e të shkruajë”) **duke iu referuar gjuhës së vet të nënës**.
- Duhet t’i japin përgjigje pyetjes 5.4 vetëm ata që pyetjes 5.3 i kanë shënuar një nga katrorët midis 06 e 08.

Për t’iu përgjigjur siç duhet pyetjeve 5.3 e 5.4 është e nevojshme t’u përmbaheni udhëzimeve të mëposhtme:

modaliteti 03: Dëftesa e shkollës fillore (ose vlerësimi final i barasvlershëm) i korrespondon përfundimit të nivelit të parë të arsimit bazë. Me dëftesën fillore është e barasvlershme certifikata e dhënë pas kursit të shkollës popullore të llojit C;

modaliteti 04: Dëftesa e shkollës tetëvjeçare (ose e përgatitjes profesionale), e marrë para krijimit të shkollës tetëvjeçare të unifikuar, i korrespondon përfundimit të nivelit të dytë të arsimit bazë. Për t’u pranuar në kurse kërkohet dëftesa e shkollës fillore (ose vlerësimi final i barasvlershëm);

modaliteti 05: Përfundimi i ulët/mesatar i Konservatorit muzikor ose i Akademisë Kombëtare të Vallëzimit.

U korrespondojnë titujve të ndërmjetëm të marrë pranë Konservatoreve të Vallëzimit para reformës të vitit 1999 (Ligji n.508/99). A.F.A.M..

Hyn në këtë modalitet diploma përfundimtare e Konservatorit të muzikës ose të Vallëzimit, por jo diploma e shkollës dytësore superiore (e mesme).

Ata që kanë diplomën përfundimtare të Konservatorit të muzikës ose të Vallëzimit dhe diplomën e shkollës së mesme duhet të shënojnë katrorin 12 (“Diploma e Akademisë së Arteve, etj...”);

modaliteti 06, 07 e 08: Diploma e institutit profesional ose Diploma e shkollës magjistrale ose Diploma e institutit të arteve e marrë pranë Institutit profesional ose Shkollës magjistrale ose Institutit të arteve dallohet në:

- **kualifikim i institutit profesional ose diplomë e shkollës magjistrale ose kualifikim i institutit të arteve** marrë në fund të një cikli studimesh të mesme prej më pak se 4 vitesh (kurs 2-3 vjeçar) që nuk lejon regjistrimin në kurset e studimeve universitare. Për pranimin në kurse kërkohet dëftesa e shkollës tetëvjeçare (ose e përgatitjes profesionale). Personat që kanë marrë si titull studimi më të lartë kualifikimin e institutit profesional ose diplomën e shkollës magjistrale ose kualifikimin e institutit të arteve, në pyetjen 5.4 duhet të shënojnë katrorin 1;
- **diploma e pjekurisë (ose provimi i shtetit)** marrë në fund të një cikli studimesh të mesme prej 4 ose 5 vitesh e që lejon regjistrimin në kurset e studimeve universitare. Për pranimin në kurse kërkohet dëftesa e shkollës tetëvjeçare (ose e përgatitjes profesionale). Personat që kanë marrë si titull studimi më të lartë diplomën e pjekurisë (ose provimin e shtetit) në institutin profesional ose në shkollën magjistrale ose në institutin e arteve, në pyetjen 5.4 duhet të shënojnë katrorin 2;

modaliteti 09: Diploma e institutit teknik e marrë në fund të një cikli studimesh të mesme prej 4 ose 5 vitesh e që lejon regjistrimin në kurset e studimeve universitare. Për pranimin në kurse kërkohet dëftesa e shkollës tetëvjeçare (ose e përgatitjes profesionale).

modaliteti 10: Diploma e institutit magjistrat e marrë në fund të një cikli studimesh të mesme prej 4 ose 5 vitesh e që lejon regjistrimin në kurset e studimeve universitare. Për pranimin në kurse kërkohet dëftesa e shkollës tetëvjeçare (ose e përgatitjes profesionale).

modaliteti 11: Diploma e liceut (klasik, shkencor, etj.) diploma e shkollës së mesme marrë në fund të një cikli studimesh në Liceun klasik ose shkencor ose gjuhësor ose artistik ose socio-psiko-pedagogjik. Merret në fund të një cikli studimesh të mesme prej 4 ose 5 vitesh e që lejon regjistrimin në kurset e studimeve universitare. Për pranimin në kurse kërkohet dëftesa e shkollës tetëvjeçare (ose e përgatitjes profesionale).

modaliteti 12: Diploma e Akademisë së Arteve, të Baletit, Artit Dramatik, ISIA, etj., Konservatori (sistemi i vjetër) i referohet kurseve të programuara para krijimit të kurseve të Formimit të Lartë Artistik, Muzikor e Koreutik (A.F.A.M.) e përfshin:

- Diplomën përfundimtare të marrë në Akademinë e Arteve të bukura, Akademinë Kombëtare të Artit Dramatik, Akademinë Kombëtare të Vallëzimit, Konservatorët e Muzikës, Institutin Superior të Industrisë Artistike (ISIA) – kurset e sistemit të vjetër, para reformës të sektorit A.F.A.M. (Ligji n.508/99).

Ata që nuk e kanë marrë as diplomën e shkollës së mesme duhet të shënojnë katrorin modalitetin 05.

Ata që kanë ndjekur edhe kursin plotësues pas-diplome duhet të shënojnë katrorin 14.

- Diplomën e marrë në Shkollën për Interpretues e Përkthyes para ligjit n.697/86 (krh. modaliteti 15);

modaliteti 13: Diploma universitare (2-3) e sistemit të vjetër (përfshirë shkollat direkte me objektiva të posaçme ose parauniversitare) dhënë në fund të një kursi universitar ose nga shkollat direkte me objektiva të posaçme. Merret pas një kursi studimesh prej jo më pak se 2 vitesh e jo më shumë se 3 (diploma e statistikës, e vigjilencës në shkollat fillore, diploma ISEF e sistemit të vjetër, diploma e paleografisë dhe e filologjisë muzikore, etj.). Diploma universitare, në nivel ndërkombëtar, i korrespondon shkallës së parë të ciklit të parë të arsimit universitar (p.sh. *bachelor's degree* - ose *first degree* – angleze). Për t'u regjistruar në këto kurse është e nevojshme diploma e shkollës së mesme (kurs prej 4-5 vitesh);

modaliteti 14: Diploma akademike e Formimit të Lartë Artistik, Muzikor e Koreutik (A.F.A.M.) e nivelit të I.

U referohemi kurseve të nisura pas reformës së sektorit A.F.A.M. (Ligji n.508/99), tek të cilat mund të regjistrohesh pas marrjes së diplomës së shkollës së mesme dhe përfshin diplomën akademike në Akademinë e Arteve të Bukura, Akademinë Kombëtare të Artit Dramatik, Akademinë Kombëtare të Vallëzimit, Konservatorët e Muzikës, Institutin Superior të Industrisë Artistike (ISIA) – kurset e sistemit të ri.

U korrespondojnë diplomave të marra në fund të kurseve trevjeçare;

Modaliteti 15: Diploma trevjeçare (e nivelit I) të sistemit të ri

Pas reformës së arsimit të lartë, parashikohen dy cikle të njëpasnjëshme: Diploma universitare dhe Diploma universitare e Specializuar/Magjistrale. Për Diplomën trevjeçare të nivelit të I janë të nevojshme 3 vite; përfshihen titujt e dhënë nga Shkolla superiore për ndërmjetës gjuhësorë e krijuar pas reformës (Ligji n.697/86);

modaliteti 16: Diploma akademike e Formimit të Lartë Artistik, Muzikor e Koreutik (A.F.A.M.) e nivelit të II.

U referohemi kurseve të nisura pas reformës së sektorit A.F.A.M. (Ligji n.508/99), tek të cilat mund të regjistrohesh pas marrjes së diplomës akademike të nivelit të I ose diplomë trevjeçare dhe përfshin diplomën akademike në Akademinë e Arteve të Bukura, Akademinë Kombëtare të Artit Dramatik, Akademinë Kombëtare të Vallëzimit, Konservatorët e Muzikës, Institutin Superior të Industrisë Artistike (ISIA) – kurset e sistemit të ri.

U korrespondojnë diplomave të marra në fund të kurseve dyvjeçare;

modaliteti 17: Diploma (4-6 vjet) e sistemit të vjetër, diplomë e specializuar ose magjistrat me cikël të vetëm të sistemit të ri, diplomë dyvjeçare e specializuar (e nivelit të II) të sistemit të ri përfshin:

- Diplomën e gjatë të sistemit të vjetër, titull studimi që merret pas një kursi studimesh universitare jo më pak se 4 vite e jo më shumë se 6. Për t'u regjistruar në këto kurse është e nevojshme diploma e shkollës së mesme (kurs 4-5 vjeçar). Diploma, në nivel ndërkombëtar, korrespondon me shkallën e dytë të ciklit të parë të arsimit universitar (p. sh. me *maitrise* franceze);
- Diplomat e Specializuara/Magjistrale me cikël të vetëm janë Farmacia, Odontoiatria, Veterinaria e Inxhinieria Ndërtim-Arkiteturë (që zgjasin 5 vjet), Mjekësia (që zgjat 6 vjet) e Drejtësia (aktive nga viti shkollor 2007/08). Për këto diploma nuk parashikohet asnjë titull pas 3 viteve të para, por vetëm në përfundim të ciklit.

Pyetja 5.5

Duke e specifikuar qartë titullin më të lartë të marrë i duhet referuar saktësisht në pyetjet 5.3 e 5.4. Si rrjedhim nuk duhen shkruar titujt e studimit pas-diplome ose pas-A.F.A.M., si master, specializime, doktoratë, etj..

Pyetja 5.6

U referohemi kurseve të formimit profesional krahinor/provincial me kohëgjatësi 6 muaj ose më shumë ku regjistrohesh me diplomën e shkollës së mesme.

Kurset e nivelit të II u rezervohen të rinjve të diplomuar me moshë më të vogël se 25 vjeç (cak që mund të ngrihet për të diplomuarit në universitet, etj.) e/o të papunësuarve me moshë mbi 25 vjeç që kanë titull studimi ose profesional të përshtatshëm.

Kurset e Arsimit e Formimit Teknik Superior (IFTS) janë kurse të financuara nga Fondi Social Europian e nga Krahuina, për formimin e Teknikëve të specializuar, figura profesionale në nivel pas-dytësor (p.sh.: Teknik i lartë për administrimin e aksidenteve në sektorin e shërbimeve të asikuracioneve, Teknik i lartë për telekomunikimet, Teknik i lartë për organizimin dhe marketingun e turizmit të integruar, etj.). Krahinat japin certifikatë Specializimi Teknik të Lartë të vlefshëm në të gjithë territorin kombëtar e të barasvlershëm me Nivelin 4 të Klasifikimit ISCED (International Standard Classification of Education).

Pyetjet 5.7 e 5.8

U referohemi kurseve të formimit profesional krahinor/provincial me kohëgjatësi 24 muaj ose më shumë ku regjistrohesh me dëftesën e shkollës tetëvjeçare.

Vetëm ata që në pyetjen 5.7 kanë shënuar katrorin 1 duhet t'i përgjigjen pyetjes 5.8, duke specifikuar kursin e formimit krahinor/provincial.

Kurse Trevjeçare Arsimit e Formimi Profesional (IFP). Janë kurse të vlefshme për kryerjen e detyrimit arsimor e për arritjen e kualifikimit profesional (si për shembull: operator për promovimin e pritjen turistike, operator i pikëshitjes, etj.). Duhet të shënojnë katrorin 1 ata që kanë përfunduar kursin pas vitit 2005.

Referime legjislative: Marrëveshja 19 qershor 2003 gjatë Konferencës së Unifikuar – Kurse eksperimentale arsimore e formimi profesional; Marrëveshja 15 janar 2004, n. 1901, në Konferencën Shteti Krahuinat; Marrëveshja 28 tetor 2004 në Konferencën e Unifikuar – Përcaktimi i kriterëve e udhëzimi i modeleve për certifikimin përfundimtare e të ndërmjetëm dhe njohja e kredive të formimit.

Të tjera Kurse formimi profesional krahinor/provincial janë kurse që u rezervohen të rinjve pa punë të sapodalë nga shkolla e detyrimit shkollor o/e të papunëve mbi 25 vjeç. Duhet të shënojnë katrorin numrin 2 ata që kanë përfunduar një kurs formimi profesional krahinor/provincial dyvjeçar ose që kanë bërë një kurs trevjeçar para vitit 2006.

Pyetjet 5.9 e 5.10

Në përgjigjen ndaj pyetjes referojuni sa thuhet në pyetjet 5.3 e 5.4. Prandaj nuk duhen të jenë konsideruar vitet e nevojshme për arritjen e titujve të studimit pas-diplome ose pas-A.F.A.M., si master, specializim, doktoratë, etj.. Duhet t'i japin përgjigje pyetjes 5.9 të gjithë ata që kanë një titull studimi (d.m.th. ata që, tek pyetja 5.3, kanë shënuar një nga katrorët ndërmjet 03 e 17). Vetëm ata që tek pyetja 5.9 kanë shënuar katrorin 1 duhet t'i përgjigjen pyetjes 5.10, duke specifikuar numrin e viteve të nevojshme nga hyrja në sistemin shkollor për marrjen e titullit jashtë shtetit. Për shembull për të marrë *bachelor's degree* amerikane ose angleze duhen gjithsej 16 vjet shkollë; për të marrë *master's degree* angleze 17 vjet, ndërsa për *master's degree* amerikane duhen 17 o 18 vjet shkollë.

Pyetja 5.11

Duhet ta shënojnë katrorin 1 personat 6 vjeç e sipër që janë regjistruar në shkollën parësore, në shkollën dytësore të shkallës së I e II, në universitetet ose në një kurs A.F.A.M..

Pyetja 5.12

U referohet kurseve të formimit profesional (falas ose me pagesë) që mund të organizohen/financohen nga subjekte të ndryshme (ndërmarrje, ente publike ose private) e që kanë të bëjnë me veprimtari të ndryshme si: kurse gjuhe, informatike, parukierë e pasticerë, etj..

Pyetjet 5.13 e 5.14

Ata që kanë bërë një Master jashtë-universitar të programuar e të administruar nga ente private e shkolla formimi, pyetjes 5.13 duhet t'i përgjigjen 2 ("Jo"). Për pyetjen 5.14 mund të jepen disa përgjigje.

Master i nivelit të I kurse që mund të ndiqen pas Diplomës trevjeçare të nivelit të I ose pas Diplomës A.F.A.M. të nivelit të I, e zgjat një vit.

Master i nivelit të II kurse që mund të ndiqen pas Diplomës së Specializimit/Magjistrale ose pas Diplomës A.F.A.M. të nivelit të II, e zgjat një vit.

Shkolla e specializimit bëhet pas Diplomës së sistemit të vjetër, pas Diplomës së Specializimit/Magjistrale me cikël të vetëm të sistemit të ri ose pas Diplomës së specializimit të sistemit të ri, në fund të një kursi studimesh jo më pak se 2 vjet që ka si synim formimin e specialistëve në sektorë të caktuar profesionalë, pranë shkollave të specializimit.

Duhet të shënojnë katrorin 3 ("Shkolla e specializimit") edhe personat që kanë "diplomë speciale" (diplomë universitare e dytë pas përfundimit të studimeve), d.m.th. të marrë pas një kursi prej të paktën 4 vjetësh pas diplomës (p.sh. Inxhinieria hapësinore).

Doktoratë shkencash (doktoratë për **Formimin e Kërkimit shkencor**) merret pas diplomës (diplomë e sistemit të vjetër, diplomë e specializimit ose magjistrale me cikël të vetëm të sistemit të ri, diplomë dyvjeçare specializimi e nivelit të II të sistemit të ri), në fund të një kursi studimesh e kërkimi personal jo më pak se 3 vjet me synim përfundimin e kërkimit shkencor e të metodologjisë kërkimore në sektorin përkatës. Në nivel ndërkombëtar **doktorata e shkencave** është titull studimi pas-diplome që barasvlen me përfundimin e ciklit të dytë të arsimit universitar (për sh. *Ph.D*).

6 Gjendja profesionale ose jo profesionale

Pyetja 6.1

Me punë nënkuptohet çdo veprimtari që synon të marrë shpërblim, rrogë, pagë, fitim, etj. Nuk duhen marrë parasysh orët që u kushtohen punëve në shtëpi, mirëmbajtje të vogla ose riparime shtëpiake, punë për qejf e të ngjashme si këto.

Duhet të shënojnë katrorin 1 ("Po") ata që:

- gjatë javës nga 2 deri më 8 tetor kanë bërë një ose më shumë orë pune të paguar në vartësi ose në mënyrë të pavarur, duke zhvilluar veprimtari të llojit të zakonshëm, rastësor ose stinor pavarësisht nga vazhdimësia e nga ekzistenca e një kontrate të rregullt pune. Duhet konsideruar çdo lloj të ardhurash: shpërblim, rrogë, fitim, pagesa të mundshme në natyrë, ushqim, banim o tjetër, edhe nëse nuk është marrë ende ose nëse është marrë në një javë tjetër nga ajo kur është bërë puna; duhet ta shënojnë katrorin 1 edhe **praktikantët e stazhierët** që marrin një pagë ose një shpërblim jo në parë mjaft që të jetë i vazhdueshëm (kuponë për ushqim, karta rimbushëse për celularin, kuponë benzine, etj.);
- gjatë javës nga 2 deri 8 tetor kanë bërë një ose më shumë orë pune duke ndihmuar një familjar në veprimtarinë e tij të pavarur, ndërmarrje ose kompani, edhe pa pagesë (ndihmës familjarë).

Me **Ndihmës familjar** nënkuptohet ai që bashkëpunon me një familjar që ka një veprimtari të vetën, pa pasur marrëdhënie pune të disiplinuar nga një kontratë (p.sh. gruaja që ndihmon burrin në dyqan, i biri që ndihmon të atin bujk).

Duhet të shënojnë katrorin 2 ("Jo") ata që:

- Gjatë javës nga 2 deri 8 tetor kanë bërë orë pune të papaguara pranë organizmave, instituteve, shoqatave e të ngjashme në cilësinë e vullnetarit në veprimtaritë e tyre;
- punonjësit stinorë që nuk kanë bërë orë pune gjatë javës së referimit.

Pyetja 6.2

Duhet të shënojnë katrorin 1 ("Po") ata që gjatë javës nga 2 deri 8 tetor kishin një punë nga e cila mungonin për një nga arsyet e mëposhtme: leje, në pritje, leje lindjeje për nënën/babin, veprimtari e reduktuar e ndërmarrjes, sëmundje, pushime, CIG (asistencë), etj.. Kjo pyetje mundëson marrjen e informacioneve për vazhdimësinë e punës e lidhja formale me të, nga pikëpamja e mungesave dhe e rrogës që merret.

Punonjësit që nuk shkojnë në punë konsiderohen të punësuar nëse mungesa nuk i tejkalon tre muajt, ose nëse gjatë mungesës vazhdojnë të marrin të paktën 50% të rrogës. Bëjnë përjashtim punonjësit që mungojnë për lejen e lindjes (mungesë e detyrueshme) ose për leje me arsye familjare (mungesë fakultative). Të vetëpunësuarit që nuk shkojnë në punë, me përjashtim të ndihmësve familjarë, konsiderohen të punësuar nëse, gjatë periudhës së mungesës, e mbajnë veprimtarinë. Ndihmësit familjarë konsiderohen të punësuar nëse mungesa nuk i tejkalon tre muajt.

Pyetja 6.3

Duhet të shënojnë katrorin 1 ("Po") ata që, gjatë 4 javëve të fundit (nga 11 shtatori deri më 8 tetor), u janë përgjigjur ofertave për punë të botuara në gazeta, kanë bërë kërkesë për të marrë pjesë në konkurse, ia kanë dërguar *jetëshkrimin* e vet ndonjë ndërmarrjeje, etj..

Përgjigjen "Po" edhe ata që do të fillojnë punë brenda 3 muajve nga data e Regjistrimit (9 tetor 2011).

Pyetja 6.5

Duhet të përgjigjen vetëm ata që tek pyetja 6.3 e tek pyetja 6.4 kanë shënuar katrorin 1 ("Po"). Për të gjithë të tjerët pyetësi rifillon tek pyetja 6.13.

Duhet të shënojnë katrorin 1 ("Po") ata që megjithëse nuk punojnë aktualisht, janë duke kërkuar punë, por që kanë zhvilluar në të kaluarën veprimtari pune të paguar ose edhe të papaguar, por në këtë rast, vetëm në cilësinë e ndihmësit familjar.

Gjatë përgjigjes së pyetjeve 6.6-6.12:

Nëse një person bën disa punë duhet të përgjigjen duke iu referuar punës kryesore që ai bën. Me punë kryesore nënkuptohet ajo të cilës i kushtohet numri më i madh i orëve të punës ose, në barazi orësh, ajo nga e cila vijin të ardhurat më të larta.

Personat në punë që gjatë javës para datës së marre së të dhënave (nga data 2 deri 8 tetor) nuk kanë bërë orë pune për shkak të lejes, sëmundjes, asistencës, pritjes, etj. duhet t'i referohen punës kryesore që bëjnë zakonisht.

Ai që aktualisht nuk punon duhet t'i referohet punës së fundit që ka bërë.

Pyetja 6.6

Punë në vartësi: punë e bërë, me ose pa kontratë, për një punëdhënës publik ose privat duke marrë shpërblim në trajtën e rrogës, pagës, rembursimit të shpenzimeve, pagës në natyrë, ushqim, banim, etj..

Përfshihen edhe:

- nxënësit, praktikantët e stazhierët **e paguar** (*stazh me pagesë, bursa studimi, pagesa për kërkime shkencore*), d.m.th. ata që në veprimtarinë e tyre alternojnë formimin, praktikën e punën;
- punonjësit e punësuar nga një agjensi pune të përkohshme;
- ata që punojnë në shtëpi të vet **në kushte vartësie me porosi** të një ose disa ndërmarrjeve.

Punë me bashkëpunim të koordinuar e të vazhdueshëm (me ose pa projekt): punë që ka të bëjë me një ose disa projekte specifike ose programe pune ose faza të saj. Karakteristikat e kësaj kontrate janë autonomia e bashkëpunëtorit dhe koordinimi me porositësin për kryerjen e punës. Punonjësi mund ta zhvillojë veprimtarinë e vet për disa porositës (përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga kontrata individuale).

Puna rastësore: me këtë kontratë punonjësi angazhohet t'i japë porositësit një vepër ose shërbim, pa asnjë lidhje vartësie e në autonomi të plotë organizative e operative. Kjo punë kualifikohet si rastësore sepse marrëdhënia përfundon me arritjen e rezultatit të bashkëpunuar edhe pse jo gjithnjë është marrëdhënie e shkurtër. Nuk është i nevojshëm regjistrimi në INPS sepse marrëdhënia është rastësore. Pra nuk parashikohen derdhje parash për sigurimet shoqërore por vetëm tatimi mbi të ardhurat, do të thotë IRPEF (mbajtje prej 20% nga shpërblimi i duhur). Ky modalitet pune nuk parashikon as kontratë të shkruar, as detyrimin për zbatimin e rregullave për parandalimin e aksidenteve ose normave të tjera të parashikuara për punonjësit e tjerë.

Sipërmarrës: ai që administron në autonomi një ndërmarrje (bujqësore, industriale, tregtare, shërbimesh, etj.) në të cilën punëson personel në vartësi. Sipërmarrësi ka të paktën një punonjës në vartësi dhe puna e tij kryesore është **organizimi e administrimi** i veprimtarisë së ndërmarrjes. Nëse, përveç organizimit e administrimit të veprimtarisë, përfshihet drejtpërdrejt në procesin prodhues e kjo punë merr karakter mbizotërues, atëherë është më e saktë të shënohet katrori 6 ("I vetëpunësuar"). Për shembull, një farkëtar që e ka punishten e vet, ku punon edhe një vartës, veprimtaria mbizotëruese e të cilit është ajo e farkëtarit më shumë se ajo e administrimit të punishtes.

Profesionist i lirë: ai që e ushtron për llogari të vet profesionin ose artin e lirë (noter, avokat, mjek dentist, inxhinier ndërtimi, etj.) në të cilën mbizotëron puna ose përpjekja intelektuale. Në këtë kontekst, profesionisti i lirë mund të rezultojë ose jo në një regjistër profesional.

I vetëpunësuar: ai që administron një ndërmarrje bujqësore, një ndërmarrje të vogël industriale ose tregtare, një punishte artizanale, një dyqan ose një shërbim publik, duke marrë pjesë me punën e vet të dorës. Hyjnë në këtë kategori edhe kultivuesit e drejtpërdrejtë, bujqit gjysmatar e të ngjashëm, ata që punojnë në shtëpi drejtpërdrejt për llogari të konsumatorëve ose jo, me porosi të ndërmarrjeve. I vetëpunësuar mund të ketë vartës ose mund të mos ketë. Ajo çka e dallon nga sipërmarrësi është fakti se përfshihet drejtpërdrejt në procesin prodhues e ky aspekt është mbizotërues në krahasim me administrimin e veprimtarisë. Prandaj, nëse punonjësi ka vartës e veprimtaria e organizimit dhe e administrimit merr karakter mbizotërues, atëherë është më e saktë të shënohet katrori 4 ("Sipërmarrës").

Ortak kooperative: ai që është anëtar aktiv i një kooperative prodhimi të mirash materiale e/o shërbimesh pavarësisht nga lloji i veprimtarisë që kooperativa bën, d.m.th. ai që si kundërvlerë të punës së bërë nuk merr shpërbim sipas kontratave të punës, por një kompensim të përpjeshtë me punën e/o një kuotë pjesë të fitimeve të ndërmarrjes.

Ndihmës familjar: ai që bashkëpunon me një familjar që ka një veprimtari të vetën, pa pasur marrëdhënie pune të disiplinuar nga një kontratë (p.sh. grua që ndihmon burrin në dyqan, i biri që ndihmon të atin bujk, etj.).

Pyetja 6.7

Duhet të përgjigjen vetëm ata që tek pyetja 6.6 kanë shënuar katrorin 1 (“Një punë në vartësi”).

- **Marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar:** i referohet marrëdhënieve të punës që nuk kanë një afat të paracaktuar;
- **Marrëdhënie pune me kohë të caktuar:** i referohet marrëdhënieve të punës që zgjidhen kur verifikohen kushte objektive e të paracaktuara (për shembull mbarimi i një afati, përfundimi i një detyre, arritja e një qëllimi, kthimi i punonjësit i zëvendësuar përkohësisht).

Pyetja 6.9

Kohë e pjesshme (part time): marrëdhënie pune, me ose pa kontratë, që parashikon një numër ore pune më të vogël se ai që është normalisht në fuqi për të punësuarit e tjerë të së njëjtës kategori. Mund të jetë e llojit:

- a) **horizontal:** kur puna bëhet në të gjitha ditët por me orar të reduktuar;
- b) **vertikal:** kur puna përqendrohet vetëm në disa ditë të javës, ose në disa javë, ose në disa muaj të vitit;
- c) **i përzier:** kur puna përfshin qoftë sistemin horizontal qoftë atë vertikal.

Për punonjësit në vartësi *part time* përcaktohet në bazë të një marrëveshjeje formale midis punëdhënësit e punonjësit.

Edhe një i vetëpunësuar mund të punojë me kohë të pjesshme (për shembull, një dyqanxhi që e zhvillon veprimtarinë e vet në dyqan vetëm në mëngjes ose pasdite punon *part time*).

Pyetja 6.10

Për t’iu përgjigjur siç duhet pyetjes, duhet t’u përmbaheni përkufizimeve të mëposhtme:

modaliteti 01: Këto profesione kërkojnë kryerjen e aktiviteteve të thjeshta e transmetuese, për të cilat nuk është e nevojshme ndonjë përgatitje e plotë në veçanti dhe që mund të sjellin përdorimin e makinerive përpunuese, duke përdorur forzën fizike dhe një pavarësi të kufizuar në gjykimin dhe iniciativën e ekzekutimit e këtyre detyrave;

modaliteti 02: Këto profesione drejtojnë dhe kontrollojnë funksionimin korrekt të makinave industriale e impianteve të prodhimit, pajisjeve, linjave të automatizuara të montazhit dhe të punës së prokukteve në seri, për të drejtuar automjete, makineritë e lëvizshme ose peshëngritëse. Të tilla aktivitete kërkojnë kryesisht njohjen bazë të përvetësimit të këtyre njohurive duke e kompletuar me detyrimin e shkollës ose një kualifikim profesional ose eksperiencë pune;

modaliteti 03: Këto profesione përdorin eksperiencën dhe zbatojnë njohuritë tekno-praktike të materialeve, të makinerive përpunuese dhe të proceseve që lidhen me nxjerrjen ose me punimin e materialeve, për ndërtimin, për riparimin dhe për mirëmbajtjen e punëve të dorës, objekteve dhe makinave, për të punuar dhe transformuar prodhimet ushqimore e bujqësore për konsum. Të tilla aktivitete kërkojnë kryesisht njohjen bazë të përvetësimit të këtyre njohurive duke e kompletuar me detyrimin e shkollës ose një cikël të shkurtër për përgatitjen e shkollës së mesme, ose një kualifikim profesional ose eksperiencë pune;

modaliteti 04: Këto profesione kultivojnë bimë dhe rrisin kafshë, planifikojnë ndjekjen e operacioneve të nevojshme për të bërë fushat më prodhuese, kopshtet, serrat dhe rritjen e kafshëve, ruajnë dhe mirëmbajnë për të shfrytëzuar prodhimet e pyllit, peshkajnë në det, në zonat e bregdetit dhe në ujrat e mbreshme, rrisin peshq dhe gjuajnë kafshë të egra. Të tilla aktivitete kërkojnë kryesisht njohjen bazë të përvetësimit të këtyre njohurive duke e kompletuar me detyrimin e shkollës ose një cikël të shkurtër për përgatitjen e shkollës së mesme, ose një kualifikim profesional ose eksperiencë pune;

modaliteti 05: Këto profesione shërbejnë klienteve në ushtrimin e tregtisë, furnizojnë shërbimet e marrjes së mallit dhe në restorante, shërbime të kryerjes dhe të mirëmbajtjes së familjes, kurimin e personave, mbajtjen e rendit publik, ruajtjen e personave dhe të pronësive. Të tilla aktivitete kërkojnë kryesisht njohjen bazë të përvetësimit të këtyre njohurive duke e kompletuar me detyrimin e shkollës ose një cikël të shkurtër për përgatitjen e shkollës së mesme, ose një kualifikim profesional ose eksperiencë pune;

modaliteti 06: Këto profesione kryejnë punë zyre me funksione jo drejtues. Në përgjithësi janë të kërkuara njohjet bazë të përvetësimit të këtyre njohurive duke e kompletuar me detyrimin e shkollës ose një cikël të shkurtër për përgatitjen e shkollës së mesme, ose një kualifikim profesional ose eksperiencë pune;

modaliteti 07: Këto profesione përzhjedhin dhe zbatojnë operativisht protokolle dhe procedura – të përcaktuara dhe të parapërcaktuara – aktivitete në prodhim ose në shërbim. Niveli i njohjes së kërkuar është bërë ndërmjet kompletimit të përgatitjes bars me shkollën e mesme, pas shkollës së mesme ose universitetit të nivelit të I, ose përgatitje praktikanti, dhe jo formalisht, të ndërlikuar;

modaliteti 08: Këto profesione kryejnë aktivitete dhe kërkojnë një nivel më të lartë të njohjes teorike për të analizuar dhe për të presantuar, në fushën e shkencave të posaçme (matematikë, fisik-inxhener, ekonomi-soçiale, intelektual,artist, etj.), situacionet dhe problemet e ndërlikuara, të përcaktohen zgjidhje të mundshme dhe të merren vendime relative. Niveli II i njohjes së kryerjes së profesioneve është njohja ndërmjet kompletimit të përgatitjes universitare të II nivel ose pas-universitare ose përgatitje praktikanti, dhe jo formalisht, të ndërlikuar;

modaliteti 09: Këto profesione përcaktojnë dhe zgjerojnë strategjitë e adresave dhe rregullimin në fushën politike, institucionale dhe ekonomike, edhe se duke përfituar nga kontributet specialiste. Niveli II i njohjes së kryerjes së profesioneve që përfshihet në këtë grup të madh nuk është gjithmonë individual e në veçanti niveli i përgatitjes formale;

modaliteti 10: Këto profesione kryen në caqet e Forcave ushtarake (Ushtria, Flota detare, Aviacioni, Karabinierët) me çdo gradë.

Në rast vështirësie telefononi në numrin jeshil 800-069701.

Pyetja 6.11

Duhet shënuar katrori që korrespondon me sektorin e veprimtarisë ekonomike ku mendohet se mund të klasifikohet veprimtaria ekskluzive ose kryesore e stabilimentit, ndërmarrjes bujqësore, dyqanit, zyrës ose entit ku punohet ose i të cilave jeni titullarë. Në veçanti:

modaliteti 01: futen në këtë kategori kultivimi i kulturave bujqësore të përhershme e jo të përhershme, riprodhimi i pemëve, rritja e kafshëve edhe bashkë me kultivimet bujqësore, gjuetia e kapja e kafshëve, silvikultura e përdorimi i zonave pyjore, peshkimi e akuakultura;

modaliteti 02: futen në këtë kategori nxjerrja e mineraleve që paraqiten në natyrë në gjendje të ngurtë, të lëngët ose të gaztë (për shembull: nxjerrja e qymyrgurit, naftës bruto, gazit natyror, gurit, rërës, argjilës torfë, kripës, nxjerrja e mineraleve metalorë me hekur e pa hekur si uranumi e toriumi). Nxjerrja mund të bëhet duke përdorur metoda të ndryshme, si përdorimi i minierave të nëndheshme ose në qiell të hapur, të puseve, nxjerrjeve detare, etj.. Kjo kategori përfshin, gjithashtu, shërbimet e mbështetjes specialiste për veprimtaritë nxjerrëse (shërbime eksplorimi të bëra nëpërmjet mbledhjes së kampionëve, shpim, ndërtim i themeleve për pusët e naftës e të gazit, lavazh, spastrim e pastrim i puseve, drenazh e pompim i minierave, etj.);

modaliteti 03: hyjnë në këtë kategori përpunimi, prodhimi e ruajtja e të gjitha produkteve ushqimore, industria e duhanit e të fibrave të tekstilit, ambalazhimi e fabrikimi i artikujve të veshmbathjeve, të artikujve të pelçerisë, të lëkurës, prodhimi i këpucëve, industria e drurit e prodhimi i mobilieve, prodhimi i artikujve me kashtë e me materiale thurëse, prodhimi i letrës, kartonit e artikujve përkatës, prodhimi i koksit e i nënprodukteve të rafinerisë së naftës, prodhimi i produkteve kimike e farmaceutike, prodhimi i bojërave, të bojërave të vajit e të smaltit, prodhimi i artikujve të gomës e lëndëve plastike, të produkteve të qelqit, porcelanës e qeramikës, prodhimi i produkteve për ndërtimin, prodhimi i produkteve metalurgjike, fabrikimi i kompjuterëve e produkteve elektronikë, optikë e elektrikë, fabrikimi i mjeteve të transportit, prodhimi i stolive, instrumenteve muzikore, i artikujve sportivë, i lodrave, i mjeteve e aparaturave mjekësore. Kjo kategori përmban edhe veprimtaritë e shtypjes së gazetave, librave, periodikëve, formularëve tregtarë e material tjetër përfshirë veprimtaritë mbështetëse, si libralidhja, përgatitja e lastrave dhe përpunimi elektronik i teksteve e imazheve, riparimi, mirëmbajtja e instalimi i makinerive dhe aparaturave;

modaliteti 04: futen në këtë kategori prodhimi, transmetimi e shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit natyror, avullit, ujit të ngrohtë e ajrit të kondicionuar nëpërmjet një infrastrukture të përhershme (rrjet) me linja, tubacion ose konduktura. Nga grupi përjashtohet administrimi i ndarë i gazsjellësve, që mbulojnë zakonisht distancat e largëta e që lidhin ndërmarrjet prodhuese me shpërndarësit e gazit ose me qendrat urbane që futen në modalitetin 08;

modaliteti 05: futen në këtë kategori mbledhja, trajtimi e furnizimi i ujit, administrimi i ujërave të zeza, mbledhja e pastrimi i ujërave të shkarkimit, mbledhja, trajtimi e përpunimi i mbeturinave të ngurta e jo të ngurta, të rrezikshme e të parrezikshme, rikuperimi e përgatitja për riciklim të hedhurinave metalike, të materialit plastik, të mbeturinave të ngurta urbane, industriale e biomasa, veprimtaria për bonifikimin (dekontaminimin) e ndërtesave e vendeve, të truallit, të ujërave sipërfaqësore e të ujërave të nëndheshme;

modaliteti 06: futen në këtë kategori ndërtimi i ndërtesave, rrugëve, linjave hekurudhore, metrove e pistave të aeroportëve, ndërtimi i urave e tuneleve, i veprave hidraulike e veprave me dobi publike për energjinë elektrike e telekomunikacionet, shkatërrimin e përgatitjen e kantierëve ë ndërtimit, instalimi i impianteve elektrike, hidraulike, përgatitja e materialeve për kornizat e dritareve, për dyshemetë, etj.;

modaliteti 07: futen në këtë kategori tregtia me shumicë e me pakicë të çdolloj artikulli. Përfshihen në këtë modalitet edhe riparimi, përveç shitjes, të automjeteve e motoçikletave. Nga grupi përjashtohet dhënia e ushqimeve e pijeve për konsum të menjëhershëm e shitja e ushqimeve për t'u marrë me vete (restorant, bar, piceri, pub, etj.) që futen në modalitetin 09;

modaliteti 08: futen në këtë kategori veprimtaritë e transportit të pasagjerëve e të mallrave të bëra rregullisht ose jo duke përdorur hekurudhën, rrugën, ujin ose avionin e veprimtaritë ndihmëse si shërbimet në terminale, administrimi i parkimeve e garazheve, qendrat e lëvizshmërisë (ndërportet) e të magazinimit të mallrave etj., veprimtaria e qiradhënies të mjeteve të transportit me shofer. Përfshihen gjithashtu veprimtaritë postare dhe shërbimet e ndërmarrjeve të transportit.

modaliteti 09: futen në këtë kategori veprimtaritë hotel ore e të animi për periudha të shkurtra në favor të vizitorëve e udhëtarëve (hotele që japin me qira dhoma, fshatra turistike, hotele për të rinj, *camping*, etj.) veprimtaritë e shërbimit ushqimor që ofrojnë vakte të plota për konsum të menjëhershëm, si në restorante tradicionale, vetëshërbim ose për t'i marrë me vete, ashtu edhe në kioska të përhershme ose të përkohshme me ose pa vende për t'u ulur (akullore, pastičeri, mensa e *catering*, bar, pub, birrari, kafe, etj.). Elementi vendimtar është se jepen vakte ushqimi për konsum të menjëhershëm, pavarësisht nga lloji i strukturës që i ofron;

modaliteti 10: futen në këtë kategori të gjitha veprimtaritë botuese përfshirë publikimi i *software*, veprimtaritë e prodhimit kinematografik, të videove, të programeve televizive, radiofonike e të regjistrimeve muzikore e të tingullit, telekomunikacionet (fikse, të lëvizshme e satelitore), konsulenca informatike e të gjitha veprimtaritë e shërbimeve të informacionit e të shërbimeve informatike (veprimtaria e portaleve të kërkimit në internet, përpunimi i të dhënave e të *hosting*, administrimi i *database*, etj.) e veprimtaritë e agjensive të shtypit e të agjensive të informacionit që japin u japin mjeteve të komunikimit informacione, imazhe e shërbime speciale;

modaliteti 11: futen në këtë kategori veprimtaritë e ndërmjetësimit financiar, përfshirë asikuracionet, riasikuracionet e fondet për pensione (përfshijtur sigurimet shoqërore të detyrueshme), si dhe veprimtaritë ndihmëse të ndërmjetësimit financiar (promotorë, agjentë, ndërmjetës e sigurues të produkteve financiare, veprimtari bankare në postë, shërbime transferimi të hollash si *money transfer*, etj.);

modaliteti 12: futen në këtë kategori veprimtaritë e qiradhënësve, agjentëve e/o ndërmjetësve që punojnë në kuadrin e një ose disa sektorëve të mëposhtëm: shitblerje ndërtesash, dhënie shërbimesh imobiliare si vlerësimi i pasurive të patundshme ose veprimtaritë e agjentëve imobiliarë për llogari të të tretëve. Veprimtaritë e përfshira në këta kategori mund të bëhen mbi pasuritë e veta të patundshme ose me qira, si dhe për llogari të të tretëve;

modaliteti 13: futen në këtë kategori veprimtaritë e specializuara profesionale, shkencore e teknike. Këto veprimtari kërkojnë nivel të lartë përgatitjeje e vënë në dispozicion të përdoruesve njohuri e aftësi të specializuara. Përfshirë

veprimtaritë e studimeve legale e të studimeve tregtare, tatimore e revizion kontabël, veprimtari drejtimi i ndërmarrjes e i konsulencës manaxheriale, veprimtaritë e studimeve teknike (të arkitekturës, të inxhinierisë, të përpilimit të projekteve, të inspektimeve ndërtimore e të veprimtarive kërkimore e të mapaturës e veprimtaritë për kolaudimet fizike, kimike ose të llojit tjetër), veprimtari kërkimore e zhvillimi në fushën e shkencave natyrore, të inxhinierisë, të shkencave humane e humaniste, publicitet (krijimi i fushatave publicitare), kërkime tregu e sondazhe të opinionit, veprimtari të specializuara vizatimi (vizatues grafikë, teknikë, etj.), veprimtari fotografike (prodhim i shërbimeve fotografike, veprimtaria e fotoreporterit, regjistrime me avion në fushën e fotografisë, etj.), përkthim dhe interpretim, konsulencë bujqësore. Kjo kategori përfshin edhe veprimtaritë e bëra nga veterinerët në klinika veterinare ose pranë fermave, në vendet ku mbahen qentë, në spitalet për kafshët, ambulatorë, ose tjetër (përfshirë shërbimet e ambulancës për kafshët);

modaliteti 14: futen në këtë kategori veprimtaritë e qiradhënies e *leasing* operativ i të mirave jo materiale jo financiare dhe një gamë e gjerë të mirash materiale si automjete pa shofer ose operator, mjetet e transportit detar e ajror, pajisje për zyra (mobile, kompjuter, fotokopiatrice, etj.), pajisje sportive e zbavitëse, videokasete e disqe, pajisje bujqësore e për punime ndërtimore e të xhenos civile. Kjo kategori përfshin edhe veprimtaritë e kërkimit, përzgjedhjes e vendosjes së personelit, veprimtaritë e agjensive të udhëtimit e të *tour operator*, shërbimet hetimore e të rojeve private e shërbimet e lidhura me sistemet e kontrollit (për shembull radiokontrolli satelitor i mjeteve të transportit), veprimtaria e pastrimit dhe i dezinfektimit (i ndërtesave, makinerive industriale, cisternave për transportin rrugor ose detar), kujdesi e mirëmbajtja e peizazhit (përfshirë parqet, kopshtet, lulishtet në ndërtesa e banesat publike e private), veprimtaritë e *call center* në hyrje e dalje, telendihmë, organizimi i konferencave dhe panairëve, si dhe një sërë veprimtarish mbështetëse për ndërmarrjet (p.sh. agjensitë e rikuperimit të kredive, kërkesa e certifikatave e përsheptimi i praktikave, etj.);

modaliteti 15: futen në këtë kategori veprimtaritë me natyrë qeveritare të zhvilluara normalisht nga administratat publike. Përfshihen veprimtaritë e përgjithshme të administrimit publik (për shembull administrimi ekzekutiv, legjislativ, financiar, etj. në të gjitha nivelet qeveritare), veprimtaritë e punëve të jashtme, të mbrojtjes, të rendit e të sigurisë publike, e drejtësisë, veprimtaritë e zjarrfikësve e të mbrojtjes civile, sigurimi shoqëror i detyrueshëm (INPS, INAIL, etj.);

modaliteti 16: futen në këtë kategori arsimit, si publik ashtu edhe privat, në çdo nivel e për çdo profesion. Veprimtaria mund të zhvillohet nëpërmjet leksioneve me gojë ose me shkrim, nëpërmjet radios, televizionit, internetit ose me korrespondencë. Përfshihet si aktiviteti arsimor i bërë nga shumë institute të sistemit shkollor kombëtar të niveleve të ndryshme, ashtu edhe arsimit për të rritur, programet kundër analfabetizimit etj.. Përfshihen gjithashtu shkollat e akademitë ushtarake brenda burgjeve. Në këtë kategori futet edhe arsimit me qëllim kryesisht sportiv e zbavitës (mësimi i tenisit, notit, kurset për aktor, vallëzim, etj.) e veprimtaritë e shkollave për patenta drejtimi (autoskolla, skolla për pilotim e lundrim);

modaliteti 17: futen në këtë kategori dhënia e shërbimeve shëndetësore dhe veprimtaria e asistencës sociale (rezidenciale e jo rezidenciale për të moshuar e të paafët dhe strukturat e asistencës për personat e prekur nga shqetësime mendore ose që abuzojnë me lëndë narkotike). Kjo kategori përfshin vizitat mjekësore e trajtimet e bëra nga mjekët e përgjithshëm, specialistë, dentistë, etj.. Veprimtari e parashikuara mund të zhvillohen në studio private, në ambulatorë ku punojnë grupe mjekësh e në klinika spitalore që bëjnë shërbime ambulatoriale pranë ndërmarrjeve, shkollave, shtëpive të pushimit, organizatave sindikale, si dhe në shtëpitë e të sëmurëve;

modaliteti 18: futen në këtë kategori një gamë e gjerë veprimtarish për përmbushjen e interesave të ndryshme kulturore, zbavitëse e argëtuese për publikun, përfshirë spektaklet *live*, administrimi i muzeve, bibliotekave, monumenteve historike, rezervave natyrore, kopshteve zoologjike, strukturave për lojëra e baste (kazinò, salla bingo, salla lojërash, etj.), veprimtaritë sportive e zbavitëse (impiante sportive, klube sportive, palestra, rezerva gjatë e peshkimi, ludoteka, salla vallëzimi, stabilimente plazhi, etj.). Përfshihen veprimtaritë e artistëve individualë;

modaliteti 19: futen në këtë kategori veprimtaritë e shoqatave (të punëdhënësve dhe ekonomike, të sindikatave të punonjësve në vartësi, të partive e të organizatave fetare), veprimtaritë e riparimit të të mirave për përdorim personal e për shtëpinë, veprimtaritë e shërbimeve për personin (lavanderitë, pastrimet kimike, floktarë e trajtimet estetike, etj.). Përfshihen veprimtaritë e riparimit të kompjuterëve dhe veprimtaritë e lavanderive industriale;

modaliteti 20: futen në këtë kategori veprimtaritë e familjeve e bashkëjetesat (përfshirë kondominiumet) si punëdhënësit për personelin shtëpiak si bashkëpunëtorët shtëpiakë, kuzhinierët, kamerierët, mazhordomët, rrobalarësit, kopshtarët, portierët, shoferët, rojet, *baby-sitter*, etj.;

modaliteti 21: futen në këtë kategori veprimtaritë e organizatave ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara e agjensitë e tyre të specializuara, BE, OSBE, FMN, Banka botërore, etj..

Në rast vështirësie telefononi në numrin jeshil 800-069701.

Pyetja 6.12

Në orarin e zakonshëm javor duhen përfshirë edhe orët e tepërta, qoftë me pagesë qoftë pa pagesë, ato që bëhen zakonisht pas orarit normal të punës eventualisht të parashikuara nga kontrata.

- Mësuesi duhet të marrë parasysh numrin e orëve të dedikuara për mësimdhënien plus numrin e orëve të dedikuara zakonisht veprimtarive që kanë të bëjnë me profesionin e tij si mësues (përgatitja e leksioneve, korrigjimi i detyrave në shtëpi, këshillat e klasës, etj.).
- Duhet **përfshirë** orët suplementare, qoftë ato me pagesë qoftë ato pa pagesë.
- Duhet **përfshirë** orët për shkuarjen nga banesa tek vendi i punës dhe ato për ngrënien e vaktit kryesor gjatë pushimit në punë.

Pyetja 6.13

Për t'iu përgjigjur siç duhet pyetjes, duhet t'u përmbaheni përkufizimeve të mëposhtme:

Marrës/e i një ose më shumë pensioneve për efekt të veprimtarisë së punës së mëparshme ose Marrës/e i të ardhurave prej kapitaleve

- **Marrës/e i një ose më shumë pensioneve për efekt të veprimtarisë së punës së mëparshme:** ai që merr një ose më shumë pensione Këto shërbime jepen për efekt të veprimtarisë së zhvilluar nga personi i mbrojtur, kur arrin një moshë të caktuar, vjetërsi kontributesh e në prani të aftësive të reduktuara për punë. Në këtë kategori përfshihen edhe pensionet dëmshpërblyese të përbëra nga renta për aksidente në punë ose sëmundje profesionale. Karakteristika e këtyre pensioneve është se dëmshpërblen personin për zvogëlimin e aftësive, sipas gradës së tij, ose për vdekje (në këtë rast shërbimi u jepet të mbijetuarve) pas një ngjarjeje të ndodhur gjatë veprimtarisë së punës. Pensionet dëmshpërblyese jepen vetëm në prani të një periudhe minimale të derdhjeve të kontributeve.
- **Marrës/e të ardhurash nga kapitale:** ai që merr të ardhura, rentë ose fitime që vijnë nga prona, investime, interesa, qira, *royalty*, etj..

Student/e: ai që i dedikohet kryesisht studimit.

Shtëpiak/e: ai që i dedikohet kryesisht kujdesit të familjes e të shtëpisë së vet.

Në gjendje tjetër: ai që gjendet në një situatë të ndryshme nga ato të rreshtuara më sipër (për shembull pensionist për arsye të ndryshme nga veprimtaria e punës, titullar i pensionit social, i pensionit të invaliditetit civil, etj.).

7 Vendi i studimit ose i punës

Pyetja 7.1

- Shënoni katrorin 1 (“Po, shkoj në vendin e studimit”) edhe për fëmijët që ndjekin çerdhen, kopshtin, etj..
- Studentët-punonjës duhet të shënojnë katrorin 2 (“Po, shkoj në vendin e punës”).
- Në rastin e punonjësve në bujqësi që punojnë pran ndërmarrjeve bujqësore e nuk kanë një vend fiks pune, shënoni katrorin 5 (“Jo, sepse nuk kam një vend fiks pune”).
- Shënoni katrorin 6 (“Jo, sepse nuk studioj, nuk punoj e nuk ndjek kurse formimi profesional”) edhe pse personi i shoqëron përditë fëmijët në shkollë por më pas nuk shkon në ndonjë vend pune ose studimi.

Pyetja 7.2

Duhet të përgjigjet vetëm ai që shkon përditë në vendin e studimit ose të punës, d.m.th. ai që ka shënuar katrorin 1 (“Po, shkoj në vendin e studimit”) ose katrorin 2 (“Po, shkoj në vendin e punës”) pyetjes 7.1.

Pyetja 7.3

Duhet të përgjigjet vetëm ai që shkon përditë në vendin e studimit ose të punës duke u nisur nga vendbanimi i zakonshëm, d.m.th. ai që ka shënuar katrorin 1 (“Nga kjo banesë”) në pyetjen 7.2.

Pyetja 7.4

- Mund të mos ketë lidhje midis vendit të punës e përgjigjes së dhënë në pyetjen 6.11. Është rasti, për shembull, i punonjësit në vartësi të një ndërmarrjeje që ka marrë me tender shërbimin e mirëmbajtjes pranë një uzine siderurgjike, i cili gjatë përgjigjes duhet t'i referohet adresës së uzinës e jo të ndërmarrjes nga e cila varet.
- Në rast se, për shembull, në datën e Regjistrimit është duke u zhvilluar veprimtari konsulente në një seli ose ndërmarrje të ndryshme nga ajo që varen, gjatë përgjigjes duhet t'i referoheni adresës së selisë së konsulencës.
- Studentët-punonjës duhet t'i referohen adresës së vendit të punës.
- Ai që e ushtron profesionin mbi mjete transporti (shoferë, punonjës hekurudhash, punonjës tramvajesh, pilotë, marinarë, etj.) duhet t'i referohet vendit ku e fillon shërbimin (parkim, stacion, magazinë, aeroport, port, etj.).
- Ai që ka dy vende studimi ose punë të zakonshme duhet të përgjigjet duke iu referuar studimit ose veprimtarisë punonjëse kryesore.

Pyetja 7.5

Ai që punon në komunën aktuale të vendbanimit të zakonshëm ose në një komunë tjetër italiane duhet të specifikojë edhe adresën e vendit të zakonshëm të studimit ose të punës.

Pyetjet 7.6 e 7.7 e 7.8

Përgjigjuni pyetjeve duke iu referuar të mërkurës së kaluar. Në rast se atë ditë nuk janë bërë zhvendosje drejt vendit të zakonshëm të studimit ose punës (për arsye të ndryshme, si greva, sëmundje, pushime, etj.) referojuni një dite tipike.

- Nëse personi gjatë së mërkurës së kaluar ka shkuar në një vend studimi ose pune të ndryshëm nga ai i zakonshmi të treguar në pyetjen 7.5 duhet t'i referohet adresës së vendit të zakonshëm të studimit ose të punës.
- Nëse gjatë së mërkurës së kaluar personi ka shkuar dy herë në vendin e zakonshëm të studimit ose të punës, duhet të përgjigjet duke iu referuar zhvendosjes së parë.

8 Vështirësi në veprimtaritë e jetës së përditshme

Siç është parashikuar me ligj nuk është e detyrueshme të përgjigjeni nga pyetja 8.1 deri tek pyetja 8.4.

Pyetja 8.1

Qëllimi i pyetjes është njohja e vështirësive ose e problemeve pamore që personat mund të kenë edhe me përdorimin e syzeve ose lenteve me kontakt. Vështirësitë, për shembull, mund të kenë të bëjnë me mosshikimin nga afër ose nga larg, me mosshikimin anash, mosshikimin nga një sy ose nga të dy. Gjatë përgjigjes merrni parasysh çdo lloj vështirësie pamore që ju mendoni se përbën problem.

Pyetja 8.2

Qëllimi i pyetjes është njohja e vështirësive ose e problemeve dëgjimore që personat mund të kenë edhe me përdorimin e aparateve të dëgjimit. Vështirësitë ose kufizimet mund të kenë të bëjnë, për shembull, mosdëgjimin edhe vetëm kur jeni në mjedise të zhurmshme ose me pamundësinë e dallimit të tingujve që vijnë nga burime të ndryshme, mosdëgjimi nga një ose dy veshët. Gjatë përgjigjes merrni parasysh çdo lloj vështirësie dëgjimore që ju mendoni se përbën problem.

Pyetja 8.3

Qëllimi i pyetjes është njohja e vështirësive ose e problemeve të lëvizjes që personat mund të kenë pa përdorimin e mjeteve ndihmëse për të lëvizur (bastunë, paterica, karrocë, etj.) ose ndihmën e dikujt. Kufizimet mund të kenë të bëjnë, për shembull, me problemet gjatë ecjes me distanca të shkurtra ose të gjata, gjatë ngjitjes ose zbritjes së shkallëve, gjatë qëndrimit në këmbë për më shumë se 1 o 2 minuta.

Pyetja 8.4

Qëllimi i pyetjes është njohja e vështirësive që personat kanë në kujtesë ose përqendrim. Përfshihen veprimtaritë e mëposhtme: kur nuk kujtohen gjëra të rëndësishme, kur nuk gjendet rruga, kur nuk mban mend çfarë i është sapo thënë, kur nuk përqendrohet tek veprimi që është duke kryer. Vështirësitë duhet të jenë të tilla që të krijojnë probleme në zhvillimin e veprimtarive të përditshme. Nuk ka interes nxjerrja e vështirësive në kujtesë ose përqendrim që shkaktohen nga stresi, nga puna e tepërt ose nga përdorimi i lëndëve narkotike.